



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.18.1-2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË GJILANIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Gjilanit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Astrit Bllaca, i mbështetur nga Kapllan Muhaxheri (udhëheqës ekipi), Enver Ramadani, Mexhit Ferati dhe Aida Podrimaj.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	30
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	31
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	34


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Gjilanit për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 08.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih Shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

‘Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes’ sepse dy shkolla të financuara nga Ministria e Arsimit si dhe tri rrugë të ndërtuara me bashkëfinancim të Ministrisë së Infrastrukturës nuk janë regjistruar, për shkak të mos transferimit të pronësisë tek komuna.

Gjithashtu, një pagesë prej 60,000€ ishte bërë si paradhënie ndaj “Caritas Kosova”, para se të pranohet ndonjë raport për kryerjen e shërbimeve sipas marrëveshjes.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi të nën kapitulli 1.2 i këtij raporti.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm i vendosur nga komuna, funksionon në mënyrë efektive në disa fusha, por dobësitë ende janë të pranishme në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



## Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

## 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 1.2 Opinioni i Auditimit

#### PËR KOMUNËN E GJILANIT

#### OPINIONI I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

### **Baza për Opinion**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Regjistri i Pasurive Fikse nuk konfirmon gjendjen e plotë të pasurive, pasi që dy shkolla të financuara nga Ministria e Arsimit si dhe tri (3) rrugë të ndërtuara me bashkëfinancim të Ministrisë së Infrastrukturës, nuk janë regjistruar sepse nuk ishte transferuar pronësia tek komuna.

Gjithashtu, një pagesë prej 60,000€ ishte bërë si paradhënie ndaj “Caritas Kosova”, para se të pranohet ndonjë raport për kryerjen e shërbimeve sipas marrëveshjes. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me çështjet e përmendura më lart.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të

zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritët që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

### 1.3 Rreziqet domethënëse në PFV

#### **Përshkrimi**

Në memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 08.10.2015, janë identifikuar dy rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keqdeklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes.

Rreziku i parë ka të bëjë me regjistrimin e pasurisë, ku dy shkolla të financuara nga Ministria e Arsimit si dhe tri rrugët e ndërtuara me bashkëfinancim të Ministrisë së Infrastrukturës nuk janë regjistruar sepse nuk ishte transferuar pronësia tek komuna. Ky rrezik është materializuar sepse nga menaxhmenti nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për ta adresuar rrezikun e paraqitur.

Rreziku i dytë domethënës që ka të bëjë me prezantimin e pagesave të palëve të treta nuk është materializuar sepse menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet e duhura.



## 1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e buxhetit;
- Nëse PVF janë nënshkruar nga ZKF dhe Kryetari;
- Nëse PVF janë përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe;
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal; dhe
- Draft plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në draft Pasqyrat Financiare ishte i nevojshëm një korrigjim financiar në lidhje me paraqitjen e subvencioneve, dhe pas sugjerimeve tona, pasqyrat ishin korrigjuar dhe dërguar në thesar.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me kornizën raportuese, me përjashtim të çështjes që PVF nuk ishin përgatitur edhe në gjuhën serbe.

### DEKLARATA E BËRË NGA KRYETARI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të Draft PVF-ve në Qeveri, duke e përjashtuar pjesën e shpalosjeve për pasuritë, mund të konsiderohet e saktë dhe paraqet pamje të qartë.

## 1.5 Rekomandimet

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar për mos regjistrim të pasurisë, që është përsëritur edhe këtë vit. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për regjistrim të gjitha pasurive kapitale.

## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore në Komunën e Gjilanit që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballlet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit kjo tregon se menaxhmenti duket i përkushtuar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga komuna lidhur me vetëvlerësimin të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe komunikimit me palët e interesit. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi i auditimit të brendshëm, gjithashtu duhet të shqyrtohen.

## 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të Komunës së Gjilanit ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2015, dy (2) rekomandime janë implementuar; katër (4) janë adresuar dhe tre (3) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Raporti i auditimit të vitit 2014, ishte diskutuar edhe në Asamblenë Komunale.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 1 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, si regjistrimi i pasurive, qeverisjes, të hyra dhe subvencionet kanë rezultuar në:

- Pamundësinë që menaxhmenti të konfirmojë plotësinë e pasurive në PVF;
- Qeverisje jo të mirë e cila redukton mundësinë që menaxhmenti të reagojë me kohë ndaj sfidave financiare, si dhe potencialisht mund të rezultojë me humbje financiare;
- Mungesa e raporteve kthyesë për arsyeshmërinë e shpenzimeve, nuk ofron sigurinë e duhur se fondet janë shfrytëzuar konform kërkesave/qëllimit të projektit.
- Jo efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe vlerë të dobët për para në praktikat e prokurimit.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

## 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Më poshtë, ne kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por do ta pasqyroj gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK në tërësi.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponentë të kontrolleve të brendshme. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;
2. Komuna nuk posedon një plan strategjik me objektiva afatgjate ku përshkruhet qartë Vizioni dhe Misioni i cili do të mund të garantoj orientimin se ku do të shkoj komuna. Trajtimi i hollësishëm në nënkapitullin 2.5.3;
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit, si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore, konsiderohen si të vendosura nga komuna dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion, edhe pse raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore;
4. Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative; dhe
5. Komuna nuk ka ndërmarrë veprime të menjëhershme për përmirësimin e aktiviteteve për fushat e vlerësuara me notën një (1) nga viti paraprak si menaxhimi i rrezikut apo mos përfshirja e disa zyrtareve autorizues në adresimin e çështjeve nga pyetësi vetëvlerësues.

- Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat ajo përballet.

### 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik. Ky regjistër identifikon rreziqet potenciale ndaj të cilave ekspozohet komuna, ndikimin e tyre, gjasat që rreziku të materializohet, dhe nivelin e rrezikut.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Komuna ende nuk ka politika të hartuara për vlerësim, identifikim dhe përcaktim të rreziqeve nëpërmjet regjistrit sipas prioritetit apo llojit. Po ashtu, mungon Menaxhimi i rrezikut, i cili do t'i mbulojë aktivitetet e përfshira në planifikimin, monitorim dhe kontroll të veprimeve që do të adresojnë rreziqet e identifikuar në mënyrë që të përmirësohen aktivitetet e komunës në arritjen e objektivave të përcaktuara.
- Rreziku** Nga mungesa e procesit të Menaxhimit të rrezikut komuna mund të ndeshet me situata të pa pritura. Si pasojë do të mund të dëmtohen ose të dështojë arritja e objektivave të vendosura nga ana e komunës si dhe ulja e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

**Rekomandimi 4** Kryetari duhet sa më parë të miratoj një strategji të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut, ku do të përcaktohet qartë qasja e menaxhmentit për reagime ndaj rreziqeve. Krahas identifikimit të rreziqeve në nivel operativ dhe strategjik, menaxhmenti duhet të hartoj edhe një plan veprimi ku përcaktohen masat e veprimit për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e mundshme.

## 2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 4 – Dobësi në Kontrollat Menaxheriale – Prioriteti i lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Ngjashëm, aktivitetet operative nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.

**Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.

**Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.

### 2.5.3 Plani Zhvillimor i Komunës

---

#### Çështja 5 – Mungesa e planit zhvillimor – Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	Komuna nuk posedon një plan zhvillimor me objektiva afatgjate ku përshkruhet qartë Vizioni dhe Misioni i cili prezanton orientimin dhe synimet e komunës në një periudhë afatmesme të zhvillimit. Komuna i referohet planit të përbashkët “Strategjia e Zhvillimit Rajonal – Ekonomik Lindje” ku përcaktohen katër (4) prioritete: Zhvillimi ekonomik i rajonit, i infrastrukturës ekonomike, i burimeve njerëzore dhe forcimi institucional. Këto objektiva të cilat janë të përbashkëta për Rajonin Ekonomik Lindje, komuna i ka përshkruar edhe me planet afatmesme të buxhetit dhe të shpenzimeve.
<b>Rreziku</b>	Mungesa e planit zhvillimor rrezikon prioritet e çështjeve kyçe të cilat kanë të bëjnë me orientimin dhe zhvillimin e komunës në periudha afatgjate.
<b>Rekomandimi 6</b>	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjate dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.

## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me katër anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe tre auditorë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. NJAB ka një plan vjetor të auditimit të aprovuar nga Kryetari dhe komiteti i auditimit. Plani i auditimit ka paraparë pesëmbëdhjetë (15) auditime. NJAB për periudhën vjetor kishte mbuluar disa nga fushat kryesore, duke përgatitur (14) raporte bazuar në planin vjetor, si dhe një angazhim të rishikimit për të verifikuar adresimin e rekomandimeve. Raportet e auditimit përmbanin të gjetura dhe rekomandime lidhur me përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv Auditimi.

---

### Çështja 6 - Mos implementimi i rekomandimeve të NJAB - Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	<p>Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë implementuar nga ana e menaxhmentit vetëm në një numër të vogël të rasteve; dhe;</li><li>2. Komiteti i Auditimit gjatë këtij viti ka mbajtur takime me Kryetarin e Komunës dhe me NJAB, por edhe më tej ndikimi i komitetit nuk është vërejtur në adresimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e aktiviteteve të organizatës.</li></ol> <p>Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e njohjes së Menaxhmentit mbi rolin dhe maksimizimin e përfitimit të shërbimeve të auditimit të brendshëm.</p>
<b>Rreziku</b>	<p>Dështimi për të adresuar rekomandimet e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e dobësive të identifikuara, jo efikasitet në sistemin e kontrollit të brendshëm, humbje financiare për komunën dhe vlerë të dobët për para.</p>
<b>Rekomandimi 7</b>	<p>Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari i Komunës duhet të rishikojë arsyet për veprimet e limituara, të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të bashkëpunoj me Komitetin e Auditimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm.</p>



## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Komuna e kupton rëndësinë një sistemi adekuat dhe të fortë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me prokurimin, të hyrat dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkon procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës (procedura standarde të operimit) të cilat sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve vendore, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>21,839,768</b>	<b>23,194,382</b>	<b>21,768,593</b>	<b>21,127,253</b>	<b>20,622,791</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	17,979,815	18,143,310	18,131,828	17,821,119	17,413,561
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	0	841,300	808,055	305,021	213,570
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	3,859,953	3,859,953	2,658,679	2,292,071	2,912,076
Donacionet e brendshme	0	139,680	40,680	21,313	36,540
Donacionet e jashtme	0	210,139	131,351	50,729	47,044

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,354,613€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme, të hyrave të bartura nga viti paraprak, në total prej 1,191,119€ si dhe i rritjes së aplikuar në vlerë 163,494€, me vendimet e Qeverisë për të mbuluar aplikimin e përvojës së punës 0.5%.

Në vitin 2015, komuna ka ekzekutuar 94% të buxhetit final, një nivel i njëjtë krahasuar me vitin 2014. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>21,839,768</b>	<b>23,194,382</b>	<b>21,768,593</b>	<b>21,127,253</b>	<b>20,622,791</b>
Pagat dhe Mëditjet	14,150,000	14,316,913	14,265,786	13,318,659	11,594,926
Mallrat dhe Shërbimet	2,857,491	3,444,564	3,011,107	2,890,858	3,128,543
Shërbimet komunale	562,200	617,291	595,739	529,412	466,999
Subvencionet dhe Transferet	674,000	874,481	625,446	556,607	606,158
Investimet Kapitale	3,596,077	3,941,134	3,270,515	3,831,717	4,826,165

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 83% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe tre projekte të reja për vitin aktual. Vonesat në zbatim janë për shkak të alokimit me vonesë të hyrave vetjake në vlerë prej 565,310€. Megjithatë, 46% e buxhetit për investime kapitale ishte shpenzuar në tre mujorin e fundit të vitit;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 163,494€, është rezultat vendimit të Qeverisë për mbulimin e 0.5% të përvojës së punës dhe një donacioni në shumë 3,417€. Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime 587,073€, përfshin të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm prej 482,920€, si dhe nga donatorët 104,153€. Sidoqoftë, suficiti domethënës kundrejt buxhetit të rritur në mallra dhe shërbime sipas zyrtarëve është alokimi me vonesë i të hyrave; dhe
- Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët në vlerën 349,819€, ndërkohë që realizimi i buxhetit është relativisht i lartë në këtë fushë, shpenzimet ishin vetëm 49%.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,859,953	3,859,953	3,627,760	3,698,330	3,289,103

Të hyrat vetjake prej 3,466,734€ ishin shpenzuar kryesisht për projekte kapitale në vlerë prej 2 milion euro, apo 57%, pjesa tjetër është shpërndarë në kategori tjera, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e THV ishte bartur 1,004,325€ në vitin 2016. Të hyrat e planifikuara, por të pa shpenzuara janë investime kapitale 562,314€, mallra dhe shërbime 204,641€, paga dhe mëditje 31,709€, subvencione dhe transfere 184,155€, dhe shërbime komunale 21,504€.

## **Rekomandimet**

---

### **Çështja 7 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë**

- E gjetura** Realizimi i buxhetit, ndonëse në përqindje duket mjaft i lartë, mbi 1 milion euro të fondeve vetjake janë bartur si të pa shpenzuara dhe kjo pjesë e suficitit ishte jashtë kontrollit të komunës. Shpenzimet e tjera kanë mundur të bëhen në fund të vitit, për obligimet e papaguara të cilat kanë arritur në nivel domethënës shih 3.7.3.
- Rreziku** Shfrytëzimi jo mjaft efektiv i fondeve në dispozicion, do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

### 3.4 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proceset e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

#### Rekomandimet

---

##### Çështja 8 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

- E gjetura** Nga shqyrtimi i kontratave dhe pagesave ne kemi identifikuar një sërë dobësish të përbashkëta. Në veçanti, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive për të parandaluar çështjet e mëposhtme:
- Ka pasur një numër të konsiderueshëm të rasteve tek mallrat dhe shërbimet ku ishin aplikuar procedura për kuotimin e çmimeve, duke iu shmangur procedurave të hapura. Në testuam rastet si:
    1. "Pastrimin e borës nga rrugët e qytetit dhe rrugët rurale" dhe përfitues ishte i njëjti OE. Vlerat e kontratave ishin 6,050€ respektivisht 6,500€; dhe
    2. Unifikimi i mbishkrimeve në drejtoritë dhe zyrat komunale në vlerë 9,481€, dhe Unifikimi i mbishkrimeve në shkollat e Komunës së Gjilanit në vlerë 9,700€.
  - Tek kontrata "Rregullimi i kanalizimit atmosferik në lagjen Arbëria" në vlerë 201,489€, pas fillimit të punimeve, përmes aneks kontratës janë realizuar punë shtesë 20,020€. Këto dy kontrata nuk kanë mjaftuar për përfundimin e projektit, është dashur të nënshkruhet edhe një kontratë me kuotim çmimesh në vlerë 9,960€, për të përfunduar projekti. Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit të dobët dhe shmangies së procedurave të hapura për pjesët e pa planifikuara.
  - Gjatë ekzaminimit fizik të mirëmbajtjes teknike renovimi i zyrës së vendit në fshatin Malishevë, organi mbikëqyrës ka pranuar disa pozicione të cilat nuk ishin përfunduar p.sh. si: Lyerja e jashtme e fasadës në sipërfaqe prej 78.55 m<sup>2</sup> në vlerë prej 353€ nuk ishte realizuar as 50% e sipërfaqes, ndërsa ishte paguar në tërësi. Furnizimi dhe vendosja e konstruksionit primar me lëndë 10x12 cm në sasi prej 3.65 m<sup>3</sup> me vlerë 657€ nuk ishte kryer.

- Rreziku** Pagesat për pozicionet e pakryera, pranimi i pozicioneve të ndryshme nga ato të kontraktuara, mos ndjekja e procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzuesve përkatës, shmangia e procedurës së hapur, planifikimi i dobët i specifikacioneve teknike të punimeve, do të rezultojë me pagesa potencialisht të parregullta dhe me humbje financiare për komunën.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuar për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe të marrë masat e duhura për evitimin e tyre në të ardhmen. Veçanërisht duhet të rris llogaridhënien e personave përgjegjës qoftë të njësisë kërkuese, zyrtarëve të prokurimit dhe menaxherëve të kontratave. Rrjedhimisht, duhet të vendosen kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuar janë adresuar.

#### **Çështja 9 – Dobësitë jo-sistematike të prokurimit – Prioritet i lartë**

- E gjetura** Nga rishikimi i kontratave, kemi identifikuar se disa kontrole menaxheriale ndaj aktiviteteve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë dhe kjo ka rezultuar si më poshtë:
- Kontrata “Ndërtimi i terreneve sportive” në vlerë 114,446€, i është shkëputur operatorit ekonomik për vonesa të konsiderueshme në realizimin e punimeve. Komuna nuk ka konfiskuar sigurinë e ekzekutimit prej 10% siç parashihet me ligjin e prokurimit, por me një vendim ka zbatuar nenin 27.1, ku për pjesën e punëve të pa përfunduara ka ndalur vetëm vlerën 2,936€, që përfaqëson kosto shtesë për komunën për kompletimin e punës, siç është paraparë në kushtet e veçanta të kontratës;
  - Kontrata për Asfaltimin e rrugës në Fsh. Zhegër, Sigurimi i ekzekutimit të kontratës kishte skaduar me datën 23.10.2015, edhe pse punimet sipas raportit përfundimtar të pranimi nga organi mbikëqyrës ishin kryer më 25.11.2015. Sigurimi i ekzekutimit duhet të jetë valid për një periudhë 30 ditë pas përfundimit të kontratës. Në këtë rast për dy muaj nuk kishte siguri të ekzekutimit për të mbështetur kontratën;
  - Në procedurën “Furnizimi me dru për ngrohje” në vlerë 259,540€, në dosjen e tenderit nuk ishte e specifikuar qartë karakteristikat e drurit, vetitë, kaloritë e drurit, i cili duhet të furnizohet por vetëm si dru për ngrohje. Çmimi i drurit në treg përcaktohet nga lloji i drurit, prandaj nuk dihet se si është vlerësuar pa e ditur llojin e ofruar; dhe

- Dy pagesa me vlerë 28,950€, për mirëmbajtjen dhe pastrimin e trotuareve, janë trajtuar si investim kapital, ndërsa asnjë element i tyre nuk përfaqëson kushtin të jetë i tillë. Vlen të sqarohet se shuma prej 28,950€ ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

#### **Rreziku**

Dështimi për të zbatuar ligjin e prokurimit dhe udhëzuesit përkatës në mënyrë konsistente, ka rezultuar në dëmtim të buxhetit nga mos konfiskimi i sigurisë së ekzekutimit, si dhe skadimi i vlefshmërisë së sigurimit të ekzekutimit rrit rrezikun që punët e kontraktuara të mos kompletohen sipas kushteve të kontratës. Specifikimi jo i qartë i zërave që prokurohen shkaktojnë kosto shtesë dhe të pa arsyeshme. Po ashtu, pagesat nga kategoritë jo të duhura të shpenzimeve shkaktojnë pasqyrim të gabuar të shpenzimeve në PVF.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen kontrole të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme dhe që të gjitha shpenzimet bëhen sipas kodeve përkatëse në përputhje me kërkesat e LMFPP-së dhe Ligjit të Buxhetit.

### **3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimi**

Shpenzimet jo përmes prokurimit janë shpenzimet për të cilat nuk aplikohen procedurat e prokurimit. Ato kanë të bëjnë me komunalitë, shpenzimet e udhëtimit dhe pagesat me bashkëfinancim.

---

## Rekomandimet

---

### Çështja 10 – Pagesa e lartë në paradhënie duke u bazuar në marrëveshje bashkëpunimi – Prioritet i lartë

**E gjetura** Me datën 23.10.2015, Kryetari i Komunës nënshkroi marrëveshje bashkëfinancimi me “Caritas Kosova” dhe Ministrinë e Shëndetësisë, për projektin “Përkujdesja shëndetësore shtëpiake dhe ambulatore në Gjilan” në vlerë prej 260,000€. Komuna e Gjilanit do të bashkë financojë në këtë projekt vlerën prej 186,000€. Pagesa si paradhënie ishte bërë ndaj “Caritas Kosova” më datë 08.12.2015 në vlerë 60,000€, apo 32% e vlerës totale. Sipas ligjit për Buxhetin e vitit 2015, operatorëve ekonomik fitues të projekteve iu ndalohen pagesat në avans mbi 5% në muajin dhjetor, dhe atë vetëm pas aprovimit nga Ministri i Financave. Poashtu “Caritas Kosova” nuk kishte ofruar asnjë dokument relevant, si: raport të punës/mbikëqyrjes apo projekt të detajuar, raport mbi numrin e punëtorëve të angazhuar, apo ndonjë raport mbi shërbimet e kryera sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit.

**Rreziku** Paradhëniet e mbështetura vetëm në memorandum përmbajnë në vete një shkallë të lartë të rrezikut që pagesat të kryhen, ndërsa projektet të mos realizohen. Komuna nuk duhet t’i kreditoj bashkë financuesit ngase pagesat e tilla janë në kundërshtim me ligjin e buxhetit dhe rregullën e thesarit mbi shpenzimin e parave publike.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë se progresi i zbatimit të marrëveshjes duhet të monitorohet dhe të raportohet në mënyrë sistematike. Komuna duhet të ndërprej praktikën e pagesave në avans dhe të zbatojë në mënyrë strikte kërkesat ligjore që të gjitha pagesat të bëhen vetëm pasi të jenë pranuar mallrat, shërbimet apo pasi të jenë kryer punimet që kanë qenë subjekt i marrëveshjes.

### Çështja 11 – Shpenzime të pa arsyetuara për Udhëtime zyrtare – Prioritet i mesëm

**E gjetura** Agjenda e një vizite të zyrtarëve komunal në Zvicër për pjesëmarrje në panair ishin datat 19-20 Maj 2015. Për njërin nga zyrtarët i cili ka udhëtuar dy ditë më herët dhe ka përfituar mëditjet, nuk ekzistojnë dëshmi për qëndrimin e tij në hotel ose aprovim nga komuna për nisje të mëhershme. Mëditjet e pa arsyetuara për dy ditë janë në vlerë prej 221€.

**Rreziku** Mungesa e dokumenteve mbështetëse për udhëtime (arsyeshmëria dhe raporti i vizitës), si dhe mbulimi jo i mirë i këtyre shpenzimeve rritë rrezikun që paraja publike nuk përdoret për qëllimet e duhura.

**Rekomandimi 12** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që për udhëtimet zyrtare të përpilojë raport të vizitës zyrtare dhe të ofrojë dëshmi në zyrën e financave për gjitha shpenzimet e udhëtimit si dhe të jenë në pajtim me UA për udhëtime zyrtare.



### 3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Komuna për vitin 2015 për këtë kategori kishte planifikuar një shumë prej 14,316,910€, ndërsa ka shpenzuar 14,265,790€. Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjësve të rinj, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollat tjera shoqëruese nga Ministria e Financave dhe aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje nga Asambleja Komunale.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 12 – Kontratat për shërbime të veçanta – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Menaxhmenti nuk i ka zbatuar kontrollat e duhura lidhur me politikat e rekrutimit, kompensimeve dhe kompletimin e dosjeve, për të siguruar se veprohet në pajtim me kërkesat e ligjit dhe rregulloret aktuale.

- Në drejtoritë komunale, ishin punësuar mbi 120 zyrtarë me kontratë për shërbime të veçanta, me kohë zgjatje prej një deri në nëntë muaj. Në sektorin e arsimit gjatë vitit janë punësuar 36 mësimdhënës si zëvendësues pa iu nënshtruar procedurave të rekrutimit;
- Pagesat për kompensime për mbajtjen e mësimit jo formal të mësimdhënësve, stafit menaxhues dhe ndihmës, nuk ishin bërë sipas përqindjeve apo tarifave të përcaktuara me rregulloren për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave vetjake; dhe
- Dëshmitë për vitet e përvojës së punës së stafit nuk ishin të pasqyruara në një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit, si bazë për pagesat e përvojës së punës.

**Rreziku** Nënshkrimi i kontratave për shërbime dhe rekrutimi duke anashkaluar procedurat e hapura të konkursit, është jo transparent dhe diskriminues ndaj kandidatëve konkurrent. Mosrespektimi i rregullores më rastin e pagesave të kompensimeve i ekspozohet rrezikut të mos realizimit të objektivave të planifikuara. Kompensimi pa dëshmi mbështetëse për përvojën e punës do të shkaktojë mbi pagesa.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të siguroj që kontratat të nënshkruhen mbi bazën e kriterëve të qarta në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe konkurrues dhe të sigurohen dëshmitë e përvojës së punës, për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Kompensimi për mbajtjen e mësimit jo formal të bëhet në përputhje me rregulloren.



### 3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet janë kategori e shpenzimeve që jepen nga komuna pa kthim të drejtpërdrejt ndaj përfitueseve të caktuar të rregulluar me rregullore komunale. Ato kryesisht u ndahen entiteteve publike dhe jo publike dhe personave fizik në nevojë. Kontrollët e zbatuara nga komuna përcaktohen me rregulloren e brendshme dhe udhëzimet e përgjithshme të shpenzimit të parasë publike.

Buxheti për kategorinë subvencione dhe transfere për vitin 2015, ishte 874,481€. Nga kjo kategori ishin shpenzuar 627,446€, apo 72% e buxhetit.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 13 - Monitorim i dobët dhe mungesa e raportimeve financiare - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Çështjet e identifikuara gjatë testimit të kategorisë subvencione dhe transfere:

- Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Teatrin e Qytetit për pagesat në vlerë prej 103,000€, nuk posedon në masë të mjaftueshme raporte financiare dhe dëshmi relevante nga përfituesit që të konfirmoj se subvencionet kanë arritur qëllimet e parapara;
- Sipas rregullores në fuqi, shuma maksimale e pagesave të subvencionit që aprohet nga Kryetari ishte 4,000€, ndërsa në dy raste kjo shumë ishte tejkaluar; dhe
- Me vendim të Kryetarit të Komunës është subvencionuar zyrtari komunal në vlerë prej 2,533€, në emër të mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit në SHBA me qëllim të aranzhimeve të takimeve të Kryetarit të Komunës në SHBA. Ky lloj shpenzimi nuk përmbushë kriteret e subvencionit, dhe është në kundërshtim me rregulloren për ndarjen e subvencioneve.

**Rreziku** Mungesa e raporteve për arsyeshmërinë e shpenzimeve, nuk ofron sigurinë e duhur se fondet e dhëna janë shfrytëzuar sipas projekt propozimeve dhe qëllimit të ndarjes së subvencioneve. Shpenzimi i mjeteve pa përmbushur kriteret subvencionit rrezikojnë që buxheti i ndarë për këtë kategori të mos arrijë qëllimet e planifikuara.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të rishikojë rastet e identifikuara për të siguruar që kontrollët në këtë fushë janë aplikuar sipas parashikimeve dhe për të siguruar që mjetet janë përdorur për qëllimin e planifikuar dhe në pajtim me rregulloret.

### 3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2015 ishin 3,627,760€, apo shprehur në përqindje rreth 94% e buxhetit të planifikuar. Të hyrat janë realizuar kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksa administrative dhe të tjera. Ekziston nevoja për përmirësim në disa procese dhe kontrole që kanë të bëjnë me planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave, me qëllim të rritjes së të hyrave dhe sigurimin e saktësisë dhe plotësisë së raportimeve.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 14 –Moskonsistencë në mes planit dhe faturimit dhe mangësi në procedurat e dhënies me qira – Prioritet i mesëm

<b>E gjetura</b>	<p>Disa nga çështjet kryesore të identifikuara tek të hyrat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Gjatë vitit 2015 ishin planifikuar të hyra nga tatimi në pronë për këtë vit dhe vitet e mëhershme në vlerë 1,360,953€, kurse faturimi vetëm për këtë vit ishte 1,499,775€;</li><li>• Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës nuk ishte zbatuar ligji ku kërkohet shpallja e tenderit publik, por ishte kryer vetëm me njoftim të Kryetarit për vazhdimin e kontratave të vitit 2014; dhe</li><li>• Në një rast komuna kishte lidhur kontratë pa procedura, për lejimin e shfrytëzimit të përkohshëm të hapësirës publike. Në kontratë nuk ishte precizuar koha për shfrytëzim të kësaj hapësire. Po ashtu, në një kontratë të lidhur për shfrytëzim të hapësirës publike, nuk është vendosur çmimi i pagesës që duhet të paguhet ndaj komunës.</li></ul>
<b>Rreziku</b>	<p>Planifikimi i të hyrave pa analiza të detajuara dhe mos arritja e inkasimit të hyrave, redukton mundësitë e komunës për realizimin e projekteve. Mungesa e transparencës gjatë dhënies në shfrytëzim të objekteve me qira, mund të rezultojë me humbje financiare për komunën, trajtim jo të barabartë të operatorëve tjerë në procedurë dhe dëmtim të interesit publik.</p>
<b>Rekomandimi 15</b>	<p>Kryetari të siguroj që fazën e planifikimit të buxhetit vjetor të shfrytëzoj të dhënat e viteve të kaluara dhe gjendjen aktuale që planifikimi të jetë sa më real. Përveç kësaj, duhet të monitoroj kontrollet aktuale të aplikuara në realizimin e të hyrave si dhe të sigurojë procedurat e nevojshme për dhënien në shfrytëzim të pasurive komunale, në mënyrë që të sigurohet transparencë, dhe të bëhet trajtimi i drejtë dhe i barabartë për të gjithë shfrytëzuesit gjatë dhënies në shfrytëzim të objekteve me qira.</p>

## 3.7 Pasuritë dhe detyrimet

### 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së vlerës të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 1.3 Rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare.

Vlera neto e pasurive të komunës në vitin 2015 ishte 199,228,860€ dhe është shpalosur në PVF.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 15 - Mos regjistrim dhe mirëmbajtje të pasurisë- Prioritet i mesëm

**E gjetura** Sistemi i regjistrimit E-pasuria ende nuk është në funksion. Komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë kanë konstatuar se jo të gjitha pasuritë kanë të bashkëngjitur numrin identifikues, dhe se ka inventar që është nxjerrë jashtë përdorimit si pasojë e vjetërsisë, por ende nuk e kishte hequr nga regjistri i pasurisë.

**Rreziku** Menaxhimi i dobët i regjistrave të pasurive mund të rezultojë në humbjen apo përvetësimin e pasurive dhe vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të rishikojë pse pasuritë e identifikuara nuk janë regjistruar në sistemin E-pasuria, dhe të adresojë dobësitë që kanë të bëjnë me azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrat të pasurisë. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi.

### 3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Komuna nuk ka arritur t'i arkëtoj të gjitha borxhet për të cilat ka ofruar shërbime. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: Tatimi në pronë, të hyrat nga qiratë dhe taksat e aktivitetit të biznesit. Mungesa e politikave adekuate dhe masave konkrete për mbledhjen e të hyrave të grumbulluara, ka rezultuar me nivele të larta të llogarive të arkëtueshme. Megjithatë, vlen të theksohet se ligji për faljen e borxheve mund të ketë ndikuar në rënien e normës së inkasimit të borxheve të mbetura nga vitet e kaluara.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 16 – Mungesa e masave konkrete për mbledhjen e borxheve - Prioritet i lartë

**E gjetura** Borxhet totale ndaj komunës, në fund të vitit 2015 ishin 10,600,230€, pa ndonjë ndryshim të theksuar nga viti i kaluar. Sfida kryesore mbetet inkasimi i tatimit në pronë në vlerë 8,442,070€, pastaj, taksat nga veprimtaritë e biznesit 1,795.630€, qiraja nga prona dhe objektet 329,130€, dhe nga partneritet publiko private 33,400€. Çështjet tjera lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë:

- Gjatë testimit të mostrave të tatimit në pronë kemi identifikuar që gjashtë (6) tatimpagues, nuk kishin paguar borxhin në tërësi;
- Nga testimi i shtatë (7) mostrave të shfrytëzuesve me qira të pasurisë publike, ka rezultuar se gjashtë (6) prej tyre i kishin mbetur borxh komunës shumë prej 89,818€; dhe
- Nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë, ishin realizuar vetëm 62% të planifikimit.

**Rreziku** Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme, mund të rezultojë me rritjen e këtyre llogarive, dhe rrjedhimisht edhe me humbje financiare për komunën. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

**Rekomandimi 17** Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave të konsiderueshme dhe të ndërmerri veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.

### 3.7.3 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 1,898,240€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Komuna në vazhdimësi ka bërë disa përpjekje për të siguruar fonde shtesë nga qeveria, por që nuk kanë rezultuar me përgjigje pozitive, andaj për mbulimin e obligimeve të mëhershme janë reduktuar shpenzimet në kategori tjera dhe ndryshime të disa projekteve.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 17 - Niveli i lartë i obligimeve dhe rritja e detyrimeve kontingjente - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna ka arritur të zvogëlojë obligimet e papaguara nga 2,051,740€, sa ishin në vitin e kaluar, në 1,898,240€ deri në fund të vitit 2015. Pavarësisht këtij fakti, komuna përballet edhe me detyrime kontingjente në vlerë 5,172,640€. Këto obligime të papaguara dhe detyrimet kontingjente ngarkojnë drejtpërsëdrejti buxhetin e vitit 2015, siç është rasti i pagesës direkte 41,217€, nga thesari në bazë të një vendimi gjyqësor.

**Rreziku** Niveli i lartë i obligimeve të papaguara dhe rritja e obligimeve kontingjente, shton rrezikun që buxheti të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore. Fakti që komuna ka mbi shtatë (7) milionë detyrime potenciale, mund të rrezikoj seriozisht ekuilibrin buxhetor dhe të sjellë komunën në një situatë tejet të vështirë financiare, dhe po që se këto detyrime ekzekutohen gjatë vitit 2016, atëherë komunës i mbetet buxhet i sigurt vetëm për paga.

**Rekomandimi 18** Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të komunës, duhet të ndërmerret një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, duke iu shmangur ekzekutimeve direkte nga MF.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.



158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Rreziqet sinjifikante-Pasuritë	<b>Rekomandimi 1</b> - Prioritet i lartë - Kryetari duhet të identifikojë veprimet e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2015. Regjistrat e pasurisë duhet të jenë gjithëpërfshirës dhe me informacione të mjaftueshme, të mbështetura me procesin e inventarizimit dhe për t'i mundësuar Menaxhmentit të konfirmoj saktësinë dhe plotësinë e pasurive para se PVF të përgatiten.			X
Adresimi i rekomandimeve nga viti i kaluar	<b>Rekomandimi 2</b> - Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të viteve të më hershme duhet të shqyrtohen.		X	
Qeverisja e mirë	<b>Rekomandimi 3</b> - Kryetari duhet të bëjë rishikim sistematik të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave të raportimit për të përmirësuar qeverisjen. Gjithashtu, Kryetari të siguroj se rreziqet potenciale të nivelit të lartë që shoqërojnë aktivitetet operative dhe administrative janë identifikuar, dhe masat adekuate të veprimit për parandalimin dhe menaxhimin e këtyre rreziqeve janë në veprim.			X

Të hyrat	<b>Rekomandimi 4</b> - Kryetari duhet të siguroj se ligji dhe rregulloret relevante për dhënien në shfrytëzim të pasurive komunale gjejnë zbatim të plotë dhe që sa më parë të zhvillohen procedurat e nevojshme për dhënien në shfrytëzim të pasurive komunale. Ndryshimi i çmimit të kontratës publike fillestare me aneks kontratë duhet të rishqyrtohet, dhe rastet e tilla nuk duhet të përsëriten.		Pjesërisht sepse gjatë vitit 2015 ndërtimet kishin filluar para se të pajiseshin me leje ndërtimore	
Shpenzimet me prokurim	<b>Rekomandimi 5</b> - Kryetari duhet të siguroj që procesi i prokurimit të jetë i bazuar në një plan të mirë të nevojave për blerje duke u fokusuar në një proces efektiv të prokurimit që siguron vlerë ekuivalente për paranë e shpenzuar. Kërkesat e prokurimit duhet të përmbledhen qartë dhe me kohë nga njësitë kërkuuese të prokurimit për të eliminuar nevojën për procedura të shpeshta.			X
Shpenzimet me prokurim	<b>Rekomandimi 6</b> - Kryetari duhet të shqyrtojë arsyet përse kontratat u janë dhënë operatorëve më të shtrenjtë ose të pa përgjegjshëm. Një monitorim më i shtuar nevojitet për komisionet e vlerësimit për të garantuar një vlerësim të drejtë dhe sipas kërkesave ligjore	X		
Subvencionet dhe Transferet	<b>Rekomandimi 7</b> - Kryetari të siguroj se subvencionet të jenë subjekt i monitorimit nga zyrtarët komunal dhe se rezultatet nga ky proces raportohen formalisht tek Menaxhmenti duke përcaktuar kërkesat për raportim të përfituesve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve në vendimet për subvencionim. Aty ku kërkesat nuk respektohen, masa adekuate duhet të ndermirren.			X

Trajtimi i të arkëtueshmeve	<b>Rekomandimi 8</b> - Kryetari të siguroj që politika dhe masa adekuate do të ndermirën për të inkasuar borxhet e vitit aktual dhe ato të grumbulluara. Kryetari duhet që në mënyrë aktive t'i shqyrtojë të gjitha opsionet, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar se pagesat e prapa mbetura do të kryhen.		Pjesërisht sepse edhe pse një taskë forcë ishte themeluar, në vitin paraprak , një metodologji e till nuk ishte efektive dhe minimizimi i të arkëtueshmeve ishte simbolike.	
Sistemi i auditimit të brendshëm	<b>Rekomandimi 9</b> - Kryetari i Komunës duhet ta fuqizoj rolin e Auditorit të Brendshëm, të bashkëpunoj ngushtë dhe të maksimizoj rezultatet e punës së Auditorit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm. Komiteti i Auditimit të shqyrtoj dhe të ngritë tek Menaxhmenti nevojën për adresimin e të gjitha rekomandimeve të auditimit.	X		
Përmbledhje	9 rekomandime	2	4	3